7

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË

Nr.5747 Prot.

Lushnjw, më 16/06/2026

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK
MBI NJË SHTESË NË BUXHETIN E VITIT 2026
NGA TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR.
(Miratuar me VKB nr.126 datë 26.12.2025)

Të nderuar zonja dhe zotërinj këshilltar!

Sipas shkresës së Ministrisë së Financave nr.6787/1, datë 04.05.2026 njoftohemi që Bashkisë Lushnje i është transferuar fondi prej 11,000,000 lekë për paranfinancim nga Agjensia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC).
Ky fond vjen në formën e transfertës së pakushtëzuar dhe si i tillë duhet të miratohet në Këshill Bashkiak përdorimi i tij.
Sipas kërkesës së Bashkisë Lushnje, ky fond do të shkojë për parafinancimin e dy projekteve që tashmë Bashkia Lushnje po zbaton:

1. Projektin "RURAL COOP"
2. Projektin "Enforsa"

Drejtoria Financë –Buxhetit
Juljana HASALLA

Ervisa ÇUKO

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË

Nr.5747/1 Prot.

Lushnje, më 16/06/2026

PROJEKT-VENDIM Nr. 50
KËSHILLIT BASHKIAK
MBI NJË SHTESË NË BUXHETIN E VITIT 2026
NGA TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR
(Miratuar me VKB nr.126 datë 26.12.2025)

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij datës ___/____/ 2026, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë "**Mbi një shtesë në Buxhetin e Vitit 2026 nga Transferta E Pakushtëzuar** ", bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjin Nr. 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", Udhëzimi Nr. 2 datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026", Udhëzimit Nr. 9 datë 20.03.2018 "Për proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit" si dhe shkresës nr 1687/1 datë 04.05.2026 të Ministrisë së Financave:

PROPOZOJMË:

1. Të miratojë shtesën e të ardhurave në buxhetin e vitit 2026 me 11,000,000 lekë. (Si pjesë e transfertës së pakushtëzuar.)
2. Të miratojë shtesën e shpenzimeve prej 11,000,000 në buxhetin e vitit 2026 si më poshtë:

   a. **Për projektin "RURAL COOP" Programi AD129 "Zhvillimi Bujqësor, Ekonomik dhe Social, Produkti V413AAC në shumën 3,204,076 lekë (nga të cilat 600 +601 në shumën 2,000,000 lekë dhe 602 në shumën 1,204,076 lekë)**

   b. **Për projektin "ENFORSA" programi AA129 "Menaxhimi i Sherbimeve Mbeshtetëse" në Produktin P328 AAJ (sipas konfirmimeve nga Dega Thesarit nese do të ketë kode të tjera) në vlerën 7,795,924 lekë. Nga të cilat 5,000,000 lekë për investime dhe pjesa tjetër 2,795,924 lekë për shpenzime operative.**

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit, Zyra e Prokurimeve dhe Drejtoria e Pwrgjithsme e integrimit politikave sociale dhe informimit.
4. Vendimi hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

DREJTORIA FINANCË –BUXHETIT
Juljana HASALLA
Ervisa ÇUKO

DREJTORIA JURIDIKE
Bedri HIDA

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJË

3640
17.04.2026

Dir. Dep. Buxhetit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
AGJENCIA SHTETËRORE E PROGRAMIMIT STRATEGJIK DHE KOORDINIMIT TË NDIHMËS

Nr. 631 Prot.

Tiranë, më 15 04. 2026

Lënda: Kërkesë për mbështetje financiare në kuadër të projekteve me financim të huaj.

MINISTRISË SË FINANCAVE
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.3, Tiranë

Për dijeni:

BASHKISË LUSHNJE
Adresa: Lagjia "Kongresi Lushnje"

Të nderuar,

Bazuar në ligjin Ligj nr. 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", neni 11, pika 6, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026", jemi njohur me kërkesën e Bashkisë Lushnje, nëpërmjet shkresës Nr.2975 prot datë 27.03.2026, për mbështetje financiare me:

- fond prej **11,000,000 ALL** për mbulimin e kuotës së bashkëfinancimit në kuadër të projekteve *"ENFORSA"* (me shumën 80,049.86 EUR), nën Programin IPA Greqi-Shqipëri dhe *"RURAL COOP"* (me shumën 32,900 EUR) nën Programin IPA Interreg Europe, të financuar nga Bashkimi Evropian.

Pas analizimit të dokumentacionit mbështetës të përcjellë nga Bashkia Lushnje, si dhe argumentimit të pamundësisë së mbulimit nga burimet e veta, vlerësojmë se ky institucion duhet të mbështetet për mbulimin e pagesës të bashkëfinancimit nëpërmjet programit buxhetor "Ekzekutimi i pagesave të ndryshme", në Ministrinë e Financave.

Për sa më sipër, lutemi, vijimin e procedurës së nevojshme për mbështetjen e Bashkisë Lushnje sipas ligjit dhe udhëzimeve në fuqi për shumën e mësipërme.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ERIDANA ÇANO

AGJENCIA SHTETËRORE
E PROGRAMIMIT STRATEGJIK DHE
KOORDINIMIT TË NDIHMËS
Nr. 631 Prot.
Tiranë, më 30/03/2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 975 Prot.

Lushnje, më 27/03/2026

Lënda: Mbështetje financiare për bashkëfinancimin për projektet me financim të huaj "ENFORSA" dhe "RURAL COOP"
Drejtuar: Zj. Eridana Çano , Drejtor i Përgjithshëm, Agjensia Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës
Adresa: Rruga e Xibrakëve, Tiranë

E nderuar Zj. Çano,

Gjatë vitit 2025, Bashkia Lushnje ka filluar implementimin e projektit ENFORSA, në kuadër të programit Interreg VI-A IPA Greqi–Shqipëri, si dhe projektit RURAL COOP, në kuadër të programit Interreg Europe. Vlera e bashkëfinancimit për projektin ENFORSA është 80,049.86 euro. ndërsa për projektin RURAL COOP është 32,900 euro.

Bazuar në Udhëzimin Nr. 2, datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit 2026", Bashkia Lushnje kërkon të përfitojë një fond nga buxheti i shtetit për vitin 2026, në vlerën **11,000,000 lekë**, për të mbuluar shpenzimet e bashkëfinancimit për këto projekte.

Sipas Aneksit B të Udhëzimit, bashkëlidhur po ju dërgojmë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar:

-Marrëveshjet e nënshkruara për projektet

-Informacion mbi programet buxhetore ku janë regjistruar këto projekte dhe rëndësinë strategjike të tyre

Projekti ENFORSA është regjistruar në programin buxhetor Menaxhimi dhe shërbimet mbështetëse (AA129), ndërsa projekti RURAL COOP është regjistruar në programin buxhetor Zhvillimi ekonomik dhe Social (AD129).

Këto projekte janë të një rëndësie të veçantë, pasi fokusohen në dy prioritete strategjike të Bashkisë Lushnje: mbrojtjen nga zjarret dhe zhvillimin e bujqësisë.

Projekti "ENFORSA" synon të parandalojë dhe menaxhojë rreziqet klimatike, veçanërisht zjarret në pyje, përmes përdorimit të teknologjisë GIS dhe forcimit të qëndrueshmërisë me masa të përshtatura, duke kontribuar në mbrojtjen e mjedisit dhe duke siguruar pajisje dhe mjete për shërbimin zjarrfikës.

Projekti "RURAL COOP" fokusohet në zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale dhe malore, me theks të veçantë në sektorin e bujqësisë në Lushnjë, përmes politikave inovative, bashkëpunimit me komunitetin dhe qasjeve të gjelbra.

Argumentim i pamundësisë financiare

Bashkia Lushnje është njëkohësisht në proçes implementimi të projekteve të tjera, për të cilat duhet të përballojë me fondet e veta si parafinancimin, ashtu edhe bashkëfinancimin. Pas një analize të detajuar financiare, rezulton se është shumë e vështirë të mbulohet bashkëfinancimi me burimet tona, veçanërisht për projektin ENFORSA, për të cilin pjesa më e madhe e shpenzimeve parashikohet të kryhet gjatë vitit 2026. Mosrealizimi në kohë i këtyre shpenzimeve do të ndikonte drejtpërdrejt në mosarritjen e rezultateve të projekteve.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe mbështetjen, mbetemi në pritje të një përgjigjeje pozitive.

KRYETAR BASHKIA LUSHNJE

ERISELDA SEFA

Adresa: Lagjia "Kongresi Lushnje" Tel/Fax: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

4207
05.05.2026

Dr. Reg. Buxhetit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 6787/ 1 prot.

Tiranë, më 4 . 5 .2026

Lënda: Transferim fondi për shpenzime kapitale.

MINISTRISË SË FINANCAVE
Tiranë
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË THESARIT
Tiranë
DEGËS SË THESARIT TIRANË
Tiranë
DEGËS SË THESARIT LUSHNJE
Lushnje

Për dijeni: **AGJENCISË SHTETËRORE TË PROGRAMIMIT STRATEGJIK DHE KOORDINIMIT TË NDIHMËS (SASPAC)**
Tiranë
BASHKISË LUSHNJE

Në zbatim të ligjit nr. 87/2025 "*Për buxhetin e vitit 2026*", të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit*", të ndryshuar, të Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 14.01.2026 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026*", si dhe në mbështetje të shkresës së Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) me nr. 631/1 prot., datë 15.04.2026, miratojmë transferimin e fondeve për shpenzime kapitale, sipas tabelës bashkëlidhur.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

MINISTRI

Petrit Malaj

Tabela e transferimit të fondeve për shpenzimet kapitale

Në lekë

Ent. Qeverisjes	Ministria e Linjes	Kodi i institucionit	Emërtimi institucionit	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi i D. së Thesarit	Kodi i produktit	Emërtimi i produktit	Buxheti 2026
									Pakësohet	**11,000,000**
001	10	1010001	Aparati Ministrise se Financave	04	01130	2310000	3535	18BS007	TVSH, (Parafinancim, bashkefinancim, pagese TVSH-je dhe Detyrim Doganor)	11,000,000
									Shtohet	**11,000,000**
129	00	2129001	Bashkia Lushnje	01	04960	6040000	0922	90005AC	Fond MFE per bashkefinancimin e projekteve me financim te huaj "ENFORSA dhe "RURAL COOP"	11,000,000